Dr. Saimir Shatku
Armand Skrapi PhD (c)

KONVENTAT NDËRKOMBËTARE MBI PËRFAQËSIMIN DIPLOMATIK DHE RASTET PRAKTIKE TË FUNKSIONIMIT TË TYRE

Përfaqësimi diplomatik dhe roli i tij

Në kuadër të zhvillimit ndërkombëtar, shtetet mund të negociojnë dhe mund të këshillohen me njëri-tjetrin, apo me organizata ndërkombëtare, në momentin që kjo kërkohet nga stafi diplomatik i tyre. Për vetë faktin se këto subjekte përfaqësojnë në mënyrë direkte interesat e tyre, në mënyra të ndryshme, ato rrjedhimisht përfitojnë nga parimet ligjore të sanksionuara dhe sovraniteti i shtetit, duke i zbatuar ato gjatë veprimtarisë së tyre diplomatike.

Kjo është gjithashtu, çështje e një praktike të dobishme, pasi lidhjet diplomatike janë udhëhequr tradicionalisht me anë të ambasadorëve dhe stafit të tyre, por me zhvillimin, rritjen e tregtisë dhe marrëdhënieve tregtare, u zyrtarizua dhe u zgjerua roli dhe titulli i konsullit, si një subjekt tjetër i veçantë në fushën e përfaqësimit diplomatik.

Zhvillimi i teknologjive dhe i përhapjes së komunikimit të shpejtë stimuloi krijimin e misioneve speciale të përcaktuara për t'u dërguar në vende të veçanta për qëllime specifike dhe të emëruar drejtpërdrejt nga kryetarët e shteteve. Megjithatë, duhet pranuar se zhvillimet e fundit, si shpikja e telefonit, telegrafit, internetit dhe shërbimeve të faksit, fatkeqësisht kanë zbehur rëndësinë e personelit diplomatik tradicional, për arsye se tashmë kryetarët e shteteve dhe subjektet e tjera komunikojnë në mënyrë më të shpejtë nëpërmjet këtyre risive teknologjike, pa qenë e nevojshme të takohen me njëri-tjetrin.

Sidoqoftë, diplomatët dhe konsujt kryejnë disa detyra që lidhen me mbledhjen e informacionit, ndjekjen e aktiviteteve shoqërore, si dhe me përfaqësimin e shteteve të ndryshme, që nënkuptojnë aktivitetet tregtare dhe ekonomike.[1] Fusha e imunitetit diplomatik është një ndër çështjet

1 Shih: Konventa e Vjenës, "Mbi Marrëdhëniet Konsullore", i ndryshuar, 1961.

më shumë të debatuara dhe të pakundërshtuara të ligjeve ndërkombëtare, sepse ajo është në interesin e të gjitha shteteve për të siguruar një rrjedhë të lidhjeve diplomatike, edhe pse duhet pranuar se jo të gjitha shtetet veprojnë në përputhje me këtë qëllim, ashtu siç vuri në dukje edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me stafin diplomatik dhe konsullor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) në rastin e Teheranit. Thënë shkurt, rregullat e së drejtës diplomatike formojnë një sistem të kontrolluar dhe parashtrojnë detyrimet e veta, siç janë privilegjet dhe imunitetet që akordohen në misionet diplomatike dhe nga ana tjetër parashikojnë abuzimet që mund të kryejnë anëtarët e misionit, duke specifikuar mjetet në dispozicion për këto abuzime të mundshme.

Aktet kryesore ndërkombëtare mbi përfaqësimin diplomatik Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike

Në fushën e zhvillimit të marrëdhënieve diplomatike, kjo konventë u cilësua si e arsyeshme nga ana e shteteve demokratike, që të fiksonte të gjitha rregullat e mundshme, për sa i përket përfaqësive diplomatike, me qëllim respektimin korrekt të tyre dhe shmangien e mëtejshme të abuzimeve. Për këtë qëllim, duhej të arrihej në një marrëveshje të përgjithshme, e cila do të miratohej dhe do të zbatohej nga të gjitha shtetet që do ta nënshkruanin atë. Kjo marrëveshje hyri në fuqi në vitin 1964 dhe theksoi nevojën funksionale të privilegjeve diplomatike dhe imunitetit për një ndërhyrje më efikase në drejtim të realizimit të lidhjeve ndërkombëtare, duke treguar karakterin e misionit diplomatik, në përshtatje me kërkesat dhe kriteret e vendosura nga shteti i tij. Ajo gjithashtu kodifikon ligjin ekzistues dhe themelon ligje të tjera, me qëllim përforcimin dhe zbatimin e tyre sipas rastit.

Imuniteti dhe juridiksioni

Në ligjin ndërkombëtar lidhjet diplomatike krijohen dhe ekzistojnë mbi të gjitha nga dëshira e miratimit të ndërsjellë ndërmjet shteteve. Në qoftë se një shtet nuk dëshiron të hyjë në lidhje diplomatike, ai nuk është ligjërisht i detyruar për të bërë diçka që nuk e ka miratuar dhe të ndërfusë në legjislacionin e tij të brendshëm rregullat e përgjithshme ndërkombëtare. Duke marrë parasysh specifikat e Konventës në artikullin

4/1 të saj, shteti akreditues[2] duhet të sigurohet se miratimi i shtetit marrës është dhënë në lidhje me shefin e misionit pranë shtetit pritës dhe se ai ka marrë pëlqimin e këtij shteti. Kurse në paragrafin e dytë të kësaj Konvente, përcaktohet se shteti pritës nuk është i detyruar t'i japë shtetit akreditues arsyet e refuzimit të pëlqimit, në rast se ai e çmon të arsyeshme. Ngjashmërisht, në artikullin 9 të Konventës së Vjenës, të vitit 1961, thuhet se shteti pritës në çdo kohë dhe pa pasur nevojë të motivojë vendimin e tij, mund të informojë shtetin akreditues se shefi apo çdo anëtar tjetër i personelit diplomatik të misionit është person i padëshirueshëm ose i papranueshëm (non grada)[3] në këtë shtet.

Një person mund të deklarohet i padëshirueshëm ose i papranueshëm, para se të mbërrijë në territorin e shtetit pritës, pasi shteti pritës ka të drejtë të marrë informacion mbi cilësitë profesionale dhe personale që ai përfaqëson. Megjithatë, principi i miratimit mund të ndikohet edhe nga rregullat e tjera të ligjit ndërkombëtar. Si shembull të kësaj, Këshilli i Sigurimit në Rezolutën 748 (1992), i cili imponoi sanksione në Libi, vendosi se të gjitha shtetet duhet:

Të bëjnë reduktimin e numrit, nivelin e stafit diplomatik në Libi, të reduktojnë postin e këshilltarit, të kufizojnë ose kontrollojnë lëvizjet në territorin e tyre të të gjithë stafit.

Funksionet kryesore të misionit diplomatik janë specifikuar në artikullin 3 dhe vërtiten rreth prezantimit dhe mbrojtjes së interesave të kombeve të shteteve dërguese, duke specifikuar përkrahjen e informacionit dhe të lidhjeve shoqërore. Artikulli 13 lejon që

> *"...shefi i misionit konsiderohet se është ngarkuar me funksionet e tij në shtetin pritës që kur ka paraqitur letrat e tij kredenciale, ose që kur ka njoftuar arritjen e tij, dhe një kopje e njëllojtë e letrave të tij kredenciale i është paraqitur Ministrisë së Punëve të Jashtme të shtetit pritës, ose të një ministrie tjetër për të cilën do të jetë dhënë pëlqimi, sipas praktikës në fuqi në shtetin pritës, e cila duhet të zbatohet në një mënyrë të njëllojtë".*

Praktika shumëvjeçare ka dëshmuar se një emër i caktuar dhe i veçantë duhet të jetë në ngarkim të misionit diplomatik. Kur në vitin 1979 Libia projektoi ambasadën e saj si "njerëzit Bureaux", që duhet të luftojnë për komunitetin revolucionar, Britania e Madhe gjithashtu prezantoi emërimin e një personi të emëruar si koka e misionit.

2 Në gjuhën juridike cilësohet shteti dërgues.

3 Në gjuhën juridiko-ndërkombëtare cilësohet si person i padëshirueshëm.

Pacenueshmëria e misionit diplomatik

Për të lehtësuar drejtimet e aktiviteteve normale diplomatike, artikulli 22 i Konventës së Vjenës, specifikisht deklaron se ambientet e misionit diplomatik janë të paprekshme. Agjentëve të shtetit pritës nuk u lejohet të hyjnë brenda këtij ambienti, veçse me pëlqimin paraprak të shefit të misionit. Kjo e bën këtë një rregull absolut, të detyrueshëm për zbatim, cenimi i të cilit do të shkaktonte pasoja të rënda për të dy shtetet.

Në aksidentin e vitit 1896, në San-Jat-Sen, gjykata kineze refuzoi të përdorë mbrojtjen që i jep ligji i famshëm i Habeas Corpus Act[4], në respekt të një refugjati kinez, i cili mbajti përsëri testamentin e tij në legatën kineze të Londrës. Gjithashtu mbetet e paqartë, nëse duhet të zbatohet apo jo ky parim absolut në rastin e hyrjes, pa shprehur miratim në kërkesat e fikjes së zjarrit, ose të rrezikut të personave në atë sipërfaqe, pasi është më tepër i dyshimtë dhe justifikimi mund të deklarohet nga virtyti i nënkuptuar i mirëkuptimit që ekziston ndërmjet palëve. Shteti pritës ka detyrimin e posaçëm për të marrë të gjitha masat e përshtatshme, me qëllim që të ndalojë shkeljen ose dëmtimin e ambienteve, si dhe prishjen e qetësisë së misionit ose cenimin e dinjitetit të tij. Gjithashtu, referuar këtij parimi, mund të themi se misioni nuk duhet të përdorë qëllime të tjera, të ndryshme nga ato për të cilat është akredituar nga shteti i tij.

Në vitin 1979, ambasada e SHBA-së në Teheran u rrethua nga disa qindra demonstrues. Arkiva, dokumentet dhe disa persona nga stafi diplomatik dhe konsullor u mbajtën si pengje. Në vitin 1980, Gjykata Ndërkombëtare në një vendim të saj (bazuar kjo në Konventën e vitit 1961 dhe të vitit 1963) për lidhjet konsullore, theksoi se Irani duhet të kishte vendosur disa kategori të detyrueshme për zbatim, si një shtet pritës, duke ndërmarrë disa hapa, për të siguruar mbrojtjen e ambasadës dhe të konsullatës së SHBA-së. Kjo mbrojtje përfshinte stafin, arkivin dhe lëvizjen e lirë të anëtarëve të stafit. Këto veprime konsideroheshin gjithashtu si detyrime, nën kuadrin e ligjit të përbashkët ndërkombëtar. Gjykata Ndërkombëtare në veçanti, tensionoi sjelljet serioze të Iranit dhe konfliktin midis konduktorëve dhe detyrimeve të tij nën

> *"...të gjithë korpusin e rregullave ndërkombëtare, nën të cilin ligji diplomatik dhe konsullor është përfshirë, rregullimi i karakterit themelor në të cilin gjykata duhet përsëri të afirmohet".*

4 Miratuar në Angli, në vitin 1415.

Në 17 prill të vitit 1984, një demonstratë paqësore u organizua përpara ambasadës libaneze në Londër[5]. Nga një goditje që pësoi ambasada, rezultoi vdekja e një policeje femër. Mbas kësaj ngjarjeje, personeli diplomatik libian u evakuua dhe ndërtesa e përfaqësisë diplomatike të Libisë u kontrollua nga një diplomat i Arabisë Saudite. Armë dhe fakte të tjera të paligjshme u gjendën në vendin e ngjarjes.

Në fillim të artikullit 45, germa "a" të Konventës së Vjenës, thuhet se:

> *"...në rast ndërprerjeje të marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve, ose në qoftë se një mision thirret përfundimisht ose përkohësisht dhe në rast konflikti të armatosur, shteti pritës është i detyruar të respektojë dhe të mbrojë ambientet e misionit, si dhe pasurinë e arkivat e tij".*

Në rastin e kësaj akuze, shihet se shteti akreditues ia ka besuar ruajtjen e ambienteve, lokaleve të misionit dhe pasurinë që ndodhet aty, së bashku me dokumentacionin arkivor, një shteti të tretë të pranueshëm për shtetin pritës. (Kështu, pas incidentit, Libani, duke marrë konsensusin e Londrës, njeh si garant një shtet të tretë, Arabinë Saudite)[6].

Një rast i tillë, është parashikuar në artikullin 45, germa "c", ku thuhet se:

> *"Shteti akreditues mund t'i besojë mbrojtjen e interesave të tij shtetasve të tij të një shteti të tretë të pranueshëm për shtetin pritës".*

Gjithashtu, u ngritën sugjerime që e drejta për vetëmbrojtje mund të aplikohet në këtë kontekst. Ajo është përdorur për të justifikuar kërkimin e personelit libanez që u evakuua nga ambasada libaneze pas incidentit dhe mundësia ishte që në rrethana të limituara ajo mund të përdorej për të justifikuar hyrjen brenda në ambasadë.

Një përdorim më i saktë, i ndryshëm, rrjedh në rastet kur qëllimet e misionit janë braktisur. P.sh., Britania e Madhe miratoi premisat diplomatike dhe konsullore që u vendosën në zbatim, në vitin 1987, ku thuhej se shtetet, duke dëshiruar të përdorin tokën si premisë diplomatike ose konsullore, kanë kërkuar të mbajnë marrëdhënie mirëkuptimi me Sekretarin e Shtetit. (Ministri i Punëve të Jashtme). Mbasi arrihet ky mirëkuptim (nuk është e nevojshme në rastin e tikës, e cila ka këtë status kryesor, të arrijë deri në përkeqësim, në futjen në fuqi të aktit të vitit 1987), ajo mundet që më pas të tërhiqet. Në bazë të aktit të mësipërm, sekretari

5 J. Goldstein, *Marrëdhëniet ndërkombëtare*, 2003.

6 Parimi i shtetit protector (mbrojtës).

i Shtetit është i aftë të reklamojë premisat, të heqë disa shpenzime dhe t'i transferojë tepricën personit me të cilin ka ndarë interesat e tij. Kjo situatë u evidentua në lidhje me ambasadën kamboxhiane në Londër, ku personeli mbylli misionin diplomatik, kur Kamboxhia ra në duart e diktatorit Pol-Pot, në vitin 1975, duke mbajtur çelësat në zyrën e të huajve. Në vitin 1979, Britania e Madhe tërhoqi miratimin nga qeveria kamboxhiane pas ndërhyrjes vietnameze dhe, pas asaj date, qeveria e atij vendi nuk ka pasur më marrëveshje me ndonjë autoritet tjetër.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në rastin e konfliktit ndërmjet sistemit të azilit midis Kolumbisë dhe Perusë, theksoi se një vendim për vendosjen e një azili të drejtë përmbledh një kufizim të pavarësisë së shtetit pritës dhe cakton ndërhyrje në çështjet të cilat janë kompetenca ekskluzive e atij shteti. Zhvendosja nga territori i pavarur nuk mund të bëhet, derisa bazat e tij të ligjshme janë formuar për çdo rast të veçantë. Kur marrëveshja ekziston, duke pasur parasysh të drejtën për azilkërkim, pyetja formohet në lidhje me kompetencat e shtetit pritës ose marrës, ose me shtetin që drejton azilin dhe shtetin territorial. Ndërsa diplomatët e shtetit dërgues mund të përfundojnë në mënyrë të përkohshme, nëse një refugjati i takon e drejta për azilkërkim në një aplikim për këtë veprim. Kjo gjë nuk do ta detyronte shtetin pritës për ta mbështetur veprimin e tij, pasi një veprim i tillë është në të drejtën e shtetit pritës. Bazuar në parimet e ligjit ndërkombëtar, nuk njihet ndonjë rregull i kualifikimit përfundimtar dhe të një anshëm nga shteti pritës për të drejtën e azilit.

Valixhja diplomatike

Në artikullin 27 të Konventës së Vjenës, ku shprehet se:

> *"Shteti pritës duhet të lejojë dhe të mbrojë komunikimin e fjalës së lirë në misionet diplomatike për të gjitha qëllimet zyrtare. Komunikimi zyrtar është i pacenueshëm dhe ai përmbledh komunikimin përmes korrierëve diplomatikë, mesazheve të koduara dhe në shifra, gjithashtu misioni duhet të instalojë dhe të përdorë një radio dhënëse vetëm me aprovimin e shtetit pritës",* tregohen qartë rregullat e komunikimit në misionet diplomatike.

Referimi nga artikulli 27, paragrafi 2, thekson se korrespondenca zyrtare e misionit është e paprekshme. Ky artikull tregon gjithë korrespondencën në lidhje me misionin diplomatik dhe funksionet e saj. Në doktrinën e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ekziston gjykimi

se valixhja diplomatike nuk mund të hapet dhe as të mbahet, ndërsa pakot që përmbajnë valixhen diplomatike, përbëjnë sekret dhe janë të rezervuara për palën tjetër. Ato duhet të mbajnë shenja dalluese nga ana e jashtme e tyre dhe duhet të përmbajnë vetëm dokumente diplomatike ose sende të përdorimit zyrtar[7].

Në aksidentin "Dikoo", më 5 qershor të vitit 1984, ish-ministri nigerian ishte rrëmbyer në Londër dhe vendosur në një kuti për t'u dërguar në Nigeri. Kutia ishe hapur në aeroportin Stansted, i shoqëruar nga një person që kërkonte statusin diplomatik. Kutia nuk përmbante ndonjë shenjë apo vulë zyrtare (p.sh.: apostile), dhe në mënyrë të qartë ajo nuk ishte një çantë diplomatike, siç e parashikon artikulli 27, paragrafi 4, ku specifikohet se:

> *"Pakot që përbëjnë valixhe diplomatike duhet të përmbajnë vetëm dokumente diplomatike ose sende të përdorimit zyrtar".*

Nën vëzhgimin e dyshimtë për këtë ngjarje, ngrihet pyetja, nëse monitorimi elektronik që zhvillohet në pikat doganore apo në aeroporte, duke mos përmbledhur hapjen ose ndalimin e çantës diplomatike, është e ligjshme të ushtrohet apo jo.Në Britaninë e Madhe monitorimi elektronik i kësaj situate është i lejuar, ndonëse shtetet e tjera nuk e pranojnë këtë veprim. Është për t'u vënë re se, mbas rrethimit të ambasadës libaneze në prill të vitit 1984, valixhja diplomatike që u largua nga ambasada, nuk u kërkua. Si kurrë më parë, Libia bëri një rezervim në Konventën e Vjenës, duke rezervuar të drejtën e saj për të hapur një çantë diplomatike në prezencë të një zyrtari të çështjeve diplomatike.

Në mungesë të lejes së autoriteteve të shtetit dërgues, çanta diplomatike duhet të kthehej në vendin e saj të origjinës. Kuvajti dhe Arabia Saudite bënë rezervime të tilla, të cilat nuk ishin projektuar për këtë gjë. Kjo është për t'u krahasuar me një rezervim të rastit "Bahrini", në artikullin 27/3, që lejonte hapjen e çantës diplomatike në rrethana të caktuara. Gjithashtu, mbas aksidentit "Dikoo", ministri i Jashtëm i Britanisë së Madhe vendosi që çështja e kutisë të hapej për shkak të dyshimit te njerëzit. Kutia e kushtëzuar nga çanta diplomatike ose jo, përbënte një konsideratë relative për një të drejtë për të kërkuar. Por ajo që duhet pranuar, është fakti se një çantë diplomatike përfaqëson gjithashtu funksionin thelbësor të mbrojtjes së jetës njerëzore. Kjo duket se tregon një përjashtim të artikullit 27/3 në interesin e njerëzve, pasi përdorimi i çantës diplomatike është konsideruar i tillë nga komisioni i

7 Parashikuar kjo në artikullin 27, paragrafi 4, të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike dhe Konsullore.

së drejtës ndërkombëtare, në kontekstin e artikullit 27 dhe i parashikimeve analoge të vitit 1963 të Konventës për Marrëdhëniet Diplomatike dhe Konsullore, në vitin 1969 të Konventës së Misioneve Speciale dhe në vitin 1975 të Konventës së Prezantimit të Shteteve në lidhjet e tyre me Organizatën Ndërkombëtare. Artikulli 28 i përmbledhjes së artikujve mbi ndërlidhjet diplomatike dhe çantës diplomatike, përfundimisht të adoptuara nga Komisioni i Ligjit Ndërkombëtar i vitit 1989, lejonte që çanta diplomatike duhet të jetë e pacenueshme, kudo që personi diplomatik të ndodhet. Çanta diplomatike nuk duhet të hapet ose të ndalohet, pasi ajo duhet të jetë e lirë nga ekzaminimi i drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet pajisjeve elektronike. Në rastin e çantës konsullore vihet re se, në qoftë se autoritetet kompetente të shtetit pritës apo tranzit kanë arsye serioze për të besuar se çanta diplomatike përmban diçka tjetër, si korrespondencë zyrtare apo dokumente dhe/apo artikuj që pretendohen ekskluzivisht për përdorime zyrtare, ato mund të kërkojnë që çanta të hapet në prezencë të tyre nga një prani e autorizuar nga shteti dërgues. Në qoftë se kërkesa refuzohet nga autoritetet e shtetit dërgues, çanta kthehet në vendin e saj të origjinës[8]. Drafti i artikujve siguron një regjim diplomatik me privilegje, imunitete dhe pacenueshmëri, gjë që është e ngjashme me diplomatët qeverisës, kur ndërlidhja diplomatike ka të bëjë me një person i cili shoqërohet nga një çantë diplomatike. Ai duhet të gëzojë pacenueshmëri personale dhe nuk është i detyruar në asnjë formë apo mënyrë, që të arrestohet apo të ndalohet. Ai duhet të përfitojë nga imuniteti, nga juridiksioni kriminal dhe civil nga shteti pritës, lidhur me të gjithë veprimet që formojnë ushtrimin e funksioneve të tij. Në përgjithësi, privilegjet e tij dhe imuniteti zgjasin nga momenti që ai hyn në territorin e shtetit pritës ose tranzit, derisa ai të largohet nga ky shtet.

Godinat diplomatike

Në artikullin 22 të Konventës së Vjenës specifikohet se:

> *"Godinat dhe lokalet e misionit diplomatik janë të pacenueshme. Agjentëve të shtetit pritës nuk u lejohet të hyjnë brenda, përveçse me pëlqimin e shefit të misionit. Lokalet e misionit, pajisjet e tyre dhe sendet e tjera që ndodhen aty, si dhe mjetet e transportit të misionit, nuk mund të jenë objekt i asnjë bastisjeje, rekuizimi, vënie dorë ose masë ekzekutimi".*

8 Parashikimet e artikullit 35/3 të Konventës së Vjenës.

Pra, siç shihet nga artikulli 22 i Konventës së Vjenës, ndaj trupit diplomatik të akredituar nuk mund të ushtrohet asnjë lloj presioni nga agjentët dhe autoritetet e shtetit pritës, pasi ndaj tyre zbatohet parimi i ekstraterritorialitetit. Prekja e godinave diplomatike do të konsiderohej cenim i rëndë i këtij parimi.

Ndërsa nga artikulli 23 i Konventës së Vjenës, shohim se shteti akreditues dhe shefi i misionit diplomatik lirohen apo shfuqizohen nga të gjitha taksat dhe tatimet, detyrimet financiare dhe nga barra fiskale që ekzistojnë në shtetin pritës. Gjykata Ndërkombëtare, në rastin e ambasadës filipinase, u shpreh se në trajtimin e ligjit, ambientet e përdoruara nga shteti dërgues për nevojat e tij funksionale e diplomatike në çdo rast gëzojnë imunitet diplomatik, për faktin se shteti pritës duhet t'u sigurojë të gjithë anëtarëve të misionit lirinë e lëvizjes dhe të qarkullimit në territorin e tij, duke përfshirë edhe qarkullimin e kapitalit financiar të misionit diplomatik. Ashtu si në rastin e Shtëpisë së Lordëve në Alkom, në Republikën e Kolumbisë, për aktin e imunitetit të shtetit të vitit 1978, për një llogari të pranishme në bankën tregtare në emër të misionit diplomatik, shteti pritës i jep më pak imunitet misionit diplomatik për detyrimet që nevojiten në transaksionet tregtare. Në mënyrë që një mision diplomatik të kryejë shpenzimet e përditshme, duhet që ky i fundit të ketë imunitet. Kjo gjë bazohet në artikullin 25 të Konventës së Vjenës, ku thuhet se:

> *"Shteti pritës akordon të gjitha lehtësitë për kryerjen e funksionit të misionit diplomatik".*

Shtëpia e Lordëve bëri të qartë, se formulimi negativ i këtij parimi nënkuptonte se as ekzekutivi, po as edhe pushteti ligjor i qeverisë në shtetin pritës nuk duhet të veprojë në atë mënyrë, që të bllokojë apo të pengojë misionin në ushtrimin e të drejtave të tij.

Sipas artikullit 24 të Konventës së Vjenës, arkivat dhe dokumentet e misionit diplomatik janë të paprekshme në çdo kohë dhe në çdo vend që gjenden. Mund të themi se ato përbëjnë një material sekret dhe janë pronë e pacenueshme e misionit diplomatik. Cenimi i tyre mund të përbëjë shkak për përkeqësimin e situatës ndërmjet shteteve. Për këtë qëllim, anëtari i Dhomës së Komunave, lordi Brixh (Bridge), interpretoi artikullin 24 të Konventës së Vjenës, në lidhje me arkivat dhe dokumentet zyrtare të misionit diplomatik

> *"...si një e drejtë absolute, që i përket vetëm misionit diplomatik të shtetit akreditues".*

Imuniteti diplomatik dhe ai konsullor

Personi me cilësinë e agjentit diplomatik është i pacenueshëm, sipas artikullit 29 të Konventës së Vjenës. Ky parim është një nga rregullat më themelore të ligjit diplomatik. Ai nuk mund t'i nënshtrohet asnjë forme arrestimi apo ndalimi. Shteti pritës e trajton atë me respektin që i takon dhe merr të gjitha masat e arsyeshme për të ndaluar çdo cenim të personalitetit, të lirisë dhe dinjitetit të tij. Agjentët dhe shefat e misionit diplomatik gëzojnë imunitetet e juridiksionit penal të shtetit pritës. Ai gëzon gjithashtu imunitetin e juridiksionit të tij civil dhe administrativ të shtetit pritës, me përjashtim kjo në tri raste:

1. Për një veprim real lidhur me një ndërtesë private që ndodhet në territorin e shtetit pritës, përveçse kur agjenti diplomatik e zotëron atë për llogari të shtetit akreditues për qëllimet e misionit.
2. Për një veprim lidhur me një trashëgimi, në të cilën agjenti diplomatik figuron si zbatues i testamentit, administrator, trashëgimtar ligjor, si privat dhe jo në emër të shtetit akreditues.
3. Për një veprim lidhur me një profesion të lirë ose me një aktivitet çfarëdo, të ushtruar nga agjenti diplomatik në shtetin pritës, jashtë funksioneve të tij zyrtare.

Artikulli nr. 37 i Konventës së Vjenës, në lidhje me pjesëtarët e familjes së agjentit diplomatik, kur këta të fundit jetojnë me të, u siguron atyre mbrojtje ligjore dhe diplomatike. Kështu, atyre u sigurohen imunitetet dhe privilegjet të njëjta, siç i sigurohen edhe shefit të misionit dhe agjentit të tij, të parashikuara këto në artikullin 29 dhe 36 të Konventës së Vjenës, por me kusht që anëtarët e familjes së agjentit diplomatik të mos jenë shtetas të shtetit pritës.

Imunitetet dhe privilegjet për agjentët diplomatikë fillojnë nga momenti që personi hyn në territorin e shtetit pritës, deri nën vazhdimësinë e marrjes së postit, ose kur është në territor në momentin e marrjes së emërimit zyrtar. Artikulli 39 i Konventës së Vjenës shprehet:

> *"Çdo person ka të drejtë për privilegjet dhe imunitetet dhe përfiton prej tyre, sapo hyn në territorin e shtetit pritës për t'u vënë në krye të detyrës së tij, ose në qoftë se gjendet në këtë territor, që kur i njoftohet emërimi i tij Ministrisë së Punëve të Jashtme, ose një ministrie tjetër për të cilën do të jetë dhënë pëlqimi".*

Guvernatori i Pentonvil të SHBA-së, lord Parker (Parcer), përcaktoi si thelbësore se kërkesa për imunitet e agjentëve diplomatikë duhet të pranohet ose të njihet në disa mënyra nga ky shtet, me qëllim pajisjen e personit me imunitet diplomatik.

Artikulli 40 i Konventës së Vjenës lejon:

> *"Kur agjenti diplomatik kalon territorin, ose ndodhet në territorin e një shteti të tretë, i cili i ka akorduar vizën kur kjo është kërkuar për të marrë në dorë funksionet e tij, ose për t'u vënë në krye të detyrës. Shteti i tretë duhet t'i sigurojë paprekshmërinë dhe të gjitha imunitetet e tjera të nevojshme për të lejuar kalimin ose kthimin e tij".*

E njëjta gjë duhet të zbatohet respektivisht edhe për anëtarët e familjes së agjentit diplomatik. Ndërsa, kur funksionet e një personi që përfiton nga privilegjet e imunitetit, marrin fund, këto privilegje dhe imunitete mbarojnë normalisht në kohën kur personi largohet nga vendi, ose me skadimin e një afati që i është vendosur për këtë qëllim, por qëndrojnë deri në këtë kohë dhe në rast konflikti të armatosur. Megjithatë, imuniteti qëndron për sa u përket akteve të kryera nga personi diplomatik në ushtrimin e funksioneve të tij si anëtar i misionit, derisa misioni të konsiderohet i përfunduar respektivisht.

Në aksidentin e ndodhur në SHBA, kur ambasadori nga Guinea e Re ishte përgjegjës për një aksident serioz automobilistik, duke përfshirë dëmtimin e pesë makinave dhe dy personave, ai u tërhoq nga SHBA-ja dhe u sigurua nga shteti i tij, që çdo hetim i ligjit të brendshëm meksikan të mos kryhet ndaj personit të tij. Në këtë mënyrë, autoritetet amerikane nuk e morën parasysh ligjin ndërkombëtar, duke e refuzuar atë, në lidhje me veprimet që diplomati kishte bërë gjatë periudhës që kishte pasur imunitet si ambasador i Guineas së Re në SHBA.

Heqja dorë nga imuniteti diplomatik

Konventa e Vjenës gjithashtu parashikon rastet kur imuniteti dhe privilegjet diplomatike mbarojnë fuqinë e tyre për arsye të ndryshme. Bazuar në artikullin 32 të Konventës, shteti dërgues mund të heqë imunitetin nga juridiksioni i agjentëve diplomatikë dhe imuniteteve të tjera nën Konventën e Vjenës. Kur ndaj një agjenti diplomatik, ose një personi që përfiton nga imuniteti i juridiksionit, në bazë të artikullit 37 të Konventës, fillon një gjykim, ai nuk mund të pranohet që të parashtrojë

imunitetin e juridiksionit ndaj çdo kundërpadie që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesën kryesore. Ndërsa heqja dorë nga imuniteti dhe juridiksioni për një padi civile ose administrative nuk mund të quhet, sepse nënkupton heqjen dorë nga imuniteti, per sa i takon masave të ekzekutimit të vendimit, për të cilat është e nevojshme një dorëheqje e veçantë.

Në përgjithësi heqja dorë nga imuniteti është e pazakonshme, veçanërisht në rastet e ushtrimit të një veprimtarie me pasoja kriminale. Ndërsa dorëheqja e imunitetit nuk i takon çështjeve individuale të personit diplomatik, por ajo është për përfitimin e shtetit dërgues. Në ambasadën e Zambisë në Londër, heqja e imunitetit të një zyrtari diplomatik, për arsye se dyshohej për shpërndarje të lëndëve narkotike, në vitin 1985, bëri që Gjykata e Apelit në Fayed, "Al – Tajir", t'u bënte lutje publike autoriteteve londineze për mbrojtjen e zyrtarit diplomatik nga Zambia, duke iu referuar një rasti të ndodhur më parë, për heqjen e imunitetit të një ambasadori në Londër. Pra, siç shihet, imuniteti është e drejtë e shtetit dërgues, prandaj vetëm shteti dërgues si shtet suprem mund të heqë imunitetin e përfaqësuesve të tij.

Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore, 1963

Konsujt përfaqësojnë një kategori tjetër të agjentëve diplomatikë dhe shtetin e tyre në disa rrugë të ndryshme administrative në shtetin pritës, duke përdorur vizat, pasaportat dhe përgjithësisht reklamimin e interesave tregtare dhe kulturore të shtetit të tyre. Gjatë punës së tyre, ata bazohen jo vetëm në kapitalet e shtetit pritës, por veprojnë gjithashtu edhe në shumë qytete të rëndësishme provinciale, duke ushtruar veprimtari përfaqësimi me karakter tregtar. Funksionet e tyre politike janë të shumta, por ato nuk janë njësoj me imunitetet dhe juridiksionet si të agjentëve diplomatikë, kjo nisur edhe nga veprimtaria e veçantë që ushtrojnë. Konsujt mund të zotërojnë një komision financiar nga shteti dërgues dhe autorizimin e një shteti marrës. Ata janë të zhveshur nga taksat dhe detyrimet e zakonshme si diplomatët.

Premisat e konsujve janë të pacenueshme dhe nuk mund të cenohen nga autoritetet e shtetit pritës, pa marrë paraprakisht miratimin e shtetit akreditues. Në mënyrë të ngjashme me agjentët e tjerë diplomatikë, ata duhet të mbrohen nga ndërhyrjet ose dëmtimet e dinjitetit dhe imunitete të tilla të ngjashme ekzistojnë gjithashtu për arkivat dhe dokumentet, duke përfshirë në shumë raste edhe shkarkimin nga taksat dhe detyrimet e tjera fiskale. Artikulli 41 i Konventës së Vjenës parashikon:

"Zyrtarët konsullorë nuk duhet të mbahen apo arrestohen, përveçse në rastet e një krimi të rëndë, duke ndjekur një veprim nga autoritetet kompetente juridike".

Kur një konsull kryen një vepër penale, ai është i detyruar që të paraqitet përpara autoriteteve kompetente të shtetit pritës. Seancat duhet të organizohen në atë mënyrë, që të respektojnë pozicionin e tij zyrtar dhe të minimizojnë ushtrimin e tij në funksionet konsullore, derisa të qartësohet ngjarja. Në artikullin 43 të kësaj Konvente imuniteti i tyre nga juridiksioni është i kufizuar në çështjet kriminale dhe civile në veprimet e bëra në ushtrimet zyrtare të funksioneve konsullore.

Konventa mbi misionet speciale, 1969

Në disa raste, shtetet duhet të dërgojnë njerëz jashtë vendit të tyre, në misione speciale, në vende të veçanta, për të vepruar në disa përdorime karakterizuese në mbështetje të stafit ekzistues të misionit diplomatik e konsullor. Në këto rrethana, këto misione, qoftë për rëndësi politike apo të natyrës teknike, mund të mbështeten në imunitete të caktuara, të cilat janë rrjedhojë e Konventës së Vjenës, në analogji me modifikime të caktuara, sipas rrethanave konkrete të ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Sipas artikullit 8 të Konventës, shteti dërgues duhet të lejojë shtetin pritës të njohë masën dhe përmbajtjen e misionit, në përputhje me artikullin 17 të Konventës së Vjenës, dhe misioni duhet të pozicionohet në një vend që është pranuar më parë nga shtetet ose nga Ministria e Jashtme e shtetit pritës. Anëtarët e misioneve speciale, të cilat nuk kanë imunitet në lidhje me problemet që lindin nga një aksident me mjete, i përdorur jashtë funksioneve zyrtare të një personi të implikuar, vetëm siç është liria e lëvizjes dhe e udhëtimit, siç është e nevojshme për performancën e funksioneve të misioneve speciale, mbajnë përgjegjësi sipas ligjeve të shtetit pritës.[9]

Konventa e Vjenës në përfaqësimin e shteteve në lidhjet e tyre me Organizatën Ndërkombëtare të Karakterit Universal, 1975

Ky trajtim aplikohet në lidhje me përfaqësimin e shteteve në ndonjë organizatë ndërkombëtare të një karakteri universal, pavarësisht nëse ka

9 OKB-ja vepron sipas kritereve të nenit 55 të Kartës së OKB-së.

lidhje diplomatike ndërmjet shtetit pritës dhe dërgues. Mund të themi se ekzistojnë disa ngjashmëri midis kësaj Konvente dhe Konventës së Vjenës, të vitit 1961. Po t'i referohemi artikullit 30, shohim se stafi diplomatik gëzon komplet imunitetin nga juridiksioni penal dhe imunitetin nga juridiksioni civil apo administrativ në të gjitha rastet, i ruajtur për të gjitha çështjet e njohura në artikullin 31 të Konventës së Vjenës, të vitit 1961. Stafi administrativ, teknik dhe shërbyes është në të njëjtin pozicion si në trajtimin më të fundit, në artikullin 36 të Konventës së Vjenës. Premisat e misionit diplomatik janë të pacenueshme dhe përjashtohen nga taksat e vendit pritës. Gjithashtu edhe arkivat, dokumentet dhe korrespondencat janë të pacenueshme.

Duhet pranuar se fillimisht, Konventa e Vienës nuk është pritur në mënyrë entuziaste nga shumë shtete, për arsye të niveleve të larta të imuniteteve që ajo përcakton dhe lejon, si dhe të analogjisë së kundërt me misionin e agjentëve diplomatikë. Dallimet e rangut të imuniteteve me situatën e përgjithshme përcaktohen në konventat ekzistuese, siç është edhe Konventa për Privilegjet dhe Imunitetet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Shembulli më i rëndësishëm i Konventës për Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara, i vitit 1946, është se ka tendencën për të treguar imunitetin e Kombeve të Bashkuara dhe të personelit të saj, si dhe të theksojë pacenueshmërinë e premisave, arkivave dhe dokumenteve të saj.

Mbrojtja ndërkombëtare e personave

Konventa e vitit 1973 "Mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve në Mbrojtjen Ndërkombëtare të Personave", hyri në fuqi në vitin 1977 dhe përcaktonte se cilët quheshin *agjentë diplomatikë* dhe çfarë të drejtash gëzonin ata. Sipas dispozitave të saj, kërkohet mbrojtje e veçantë e kryetarëve të shteteve dhe të qeverive, ministrave të jashtëm kudo që ndodhen, duke u siguruar atyre mbrojtje për jetën nga vrasjet, rrëmbimet dhe nga sulmet e personave të ndryshëm në lirinë e tyre.

Përfundime

Në përfundim të këtij punimi, mund të arrijmë në konkluzionin se në përfaqësimin dhe bashkëpunimin e shteteve ndërmjet tyre, marrëdhëniet diplomatike janë tepër të rëndësishme dhe luajnë rol kryesor, për sa

i përket afirmimit dhe zhvillimit të tyre në arenën ndërkombëtare. Me qëllim përforcimin dhe zgjerimin e këtyre marrëdhënieve, nga ana e shumë shteteve janë ndërmarrë nisma të plota ligjore, në kuadër të vënies në zbatim të të gjitha rregullave ligjore të zbatimit të këtyre marrëdhënieve në një fushë të gjerë veprimi. Për këtë arsye, janë nënshkruar dhe ratifikuar disa konventa kryesore, me qëllim zbatimin korrekt të marrëdhënieve diplomatike ndërmjet shteteve, duke i kthyer dispozitat e tyre të detyrueshme për zbatim dhe të ndërfutura në legjislacionin e brendshëm.

Për vetë faktin se shtetet çdo ditë e më shumë po ndërmarrin nisma dhe po vendosin marrëdhënie të gjera bashkëpunimi ndërmjet tyre, në aspektin politik e ekonomik, zbatimi i këtyre konventave përbën një nga domosdoshmëritë më të mëdha, për sa i përket trajtimit të diplomatëve dhe përfaqësive të tjera, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Konventat më të rëndësishme për këtë qëllim, janë nënshkruar disa dekada më parë nga shumë shtete, ku ndër më të rëndësishmet janë trajtuar në këtë punim, dispozitat e të cilave zbatohen ende në ditët e sotme.

Ndër të tjera, Konventa e Vjenës e vitit 1961, trajton në mënyrë më të detajuar të gjitha funksionet dhe përcaktimet që lidhen me fushën e imuniteteve apo privilegjeve të agjentëve diplomatikë, duke përcaktuar shprehimisht mënyrën e zbatimit të tyre nga shtetet përkatëse. Kjo dëshmon edhe njëherë rëndësinë që paraqet në fushën e marrëdhënieve diplomatike miratimi dhe zbatimi i kësaj konvente nga të gjitha shtetet. Miratimi dhe nënshkrimi i konventave të mësipërme nga ana e shteteve të pavarura përbën një kuadër ligjor të plotë në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke përcaktuar edhe njëherë rëndësinë që luajnë ato në zhvillimin praktik e diplomatik.

Bibliografia

1. J. Goldstein, "Marrëdhëniet ndërkombëtare", "Dituria", Tiranë, 2003.
2. Hans J. Morgenthaw, "Politikat ndërmjet kombeve", Shtepia botuese AIIS, Tiranë, 2008.
3. Henry Kissinger, "Diplomacia", Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1999.
4. Geoff R. Berridge, "Diplomacia – teori dhe praktikë", Kolegji Universitar "Victory", Prishtinë, 2007.
5. Z. Gruda, "E drejta ndërkombëtare publike", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2002.

6. A. Puto, “E drejta ndërkombëtare publike”, Tiranë, 2008.
7. M. Dikson, “E drejta ndërkombëtare publike” (përkthim), AIIS, Tiranë, 2010.
8. Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve midis Shteteve dhe Organizatave Ndërkombëtare ose midis Organizatave Ndërkombëtare, 1961.
9. Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, 1963.
10. Konventa Mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve në Mbrojtjen Ndërkombëtare të Personave, 1973.
11. Konventa e Vjenës në përfaqësimin e shteteve në lidhjet e tyre me Organizatën Ndërkombëtare të Karakterit Universal, 1975.
12. Konventa mbi Misionet Speciale, 1969.